



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 30 regjistër (JR)
Datë 14.07.2023

Nr. 23 i vendimit
Datë 21.05.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupit gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 21.05.2024, ditën e martë, në orën 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 675, datë 16.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Alfred Balla.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet në ankim, si dhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, nëpërmjet të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 675, datë 16.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit dhe ndalimin e emërimit të tij si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare dhe shqyrtoi parashtrimet e konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ai iu nënshtroa procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni. Në përputhje me ligjin, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve ndihmëse, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
2. Nga aktet në fashikullin e Komisionit rezulton se më datë 24.03.2023, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) kërkesë për heqje dorë nga njohja/pasja e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr. {***}, datë 24.05.2023, KLGj-ja vendosi përfundimin e shqyrtimit të kërkesës së tij *pa* vendim përfundimtar për shkak të *heqjes dorë*.
3. Në vijim, me vendimin nr. 675, datë 16.06.2023, Komisioni ka vendosur të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit *pa* një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit. Në këtë vendim, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Alfred Balla ka humbur përfundimisht statusin e subjektit të rivlerësimit që kishte nga funksioni i mëparshëm. Për pasojë, ka argumentuar Komisioni, nuk është e mundur dhe do të ishte joproporcionale që kjo situatë ligjore të trajtohej në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Mbështetur në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 44/2015”), Komisioni ka vendosur të deklarojë *përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar*, për subjektin e rivlerësimit Alfred Balla.

II. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit të Komisionit, në datën 30.06.2023, ka ushtruar ankim Komisioneri Publik Florian Ballhysa. Në ankim, në parashtrimet në seancë gjyqësore publike dhe në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik pretendoi se vendimi i Komisionit duhet të *ndryshohet* në konsideratë të qëllimit të përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), për rastet e ndërprerjes/përfundimit të procesit të rivlerësimit, si dhe të mendimit/opinionit të gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar. Ankimi i Komisionerit Publik mbështetet në nenet F dhe G të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

5. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

6. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit¹, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

7. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i këtij ankimi, duke qenë se ai është ushtruar nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, trupi gjykues e shqyrtoi vendimin objekt ankimi në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve dhe përfaqësueses ligjore të subjektit të rivlerësimit, avokates Etleva Sherifi.
8. Pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çeljen e hetimit gjyqësor duke paraqitur prova të reja, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në seancën gjyqësore të datës 29.04.2024, trupi gjykues i Kolegjit vendosi: (i) riçeljen e hetimit gjyqësor; dhe (ii) të pranojë marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit që konsistojnë në korrespondencë të tij me Shkollën e Magjistraturës dhe mes kësaj të fundit dhe disa institucioneve të tjera².

¹ Më datë 16.06.2023, Komisioni u përcolli Komisionerëve Publikë njoftimin e vendimit nr. 675, datë 16.06.2023, për subjektin e rivlerësimit. Ankimi i Komisionerit Publik është përcjellë në Komision në datën 30.06.2023.

² Aktet e paraqitura janë katër shkresa nga Shkolla e Magjistraturës, përkatësisht, dy të datës 16.04.2024, që përbëjnë kthim përgjigje, e të datës 05.03.2024, që lidhet me organizimin e testimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit ex officio, dhe një e datës 19.04.2018 drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; një vërtetim [nr. {***} prot.], datë 18.06.2018, i lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës; një shkresë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, drejtuar Shkollës së Magjistraturës [nr. {***} prot., datë 09.03.2024]; korrespondencë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë me Shkollën e Magjistraturës [nr. {***} prot., datë 10.03.2024]; si dhe një vendim i datës 21.03.2018, i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës që mban nr. {***}. Së fundmi, subjekti paraqiti edhe korrespondencën e tij me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit [nr. {***} prot., datë 17.04.2024], bashkëlidhur së cilës ndodhen tre vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përkatësisht të datave 07.03.2018 dhe 26.02.2019 e 13.02.2020, që lidhen me ngritjen e trupave gjykues që do të vendosnin për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit; një vendim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 17.12.2021 “Për shpërndarjen me short të veçantë dhe të posaçëm të çështjes së subjektit të rivlerësimit Alfred Balla”; shkresë e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, datë 27.12.2022,

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

9. Në vendimin objekt ankimi, Komisioni arsyetoi se ndonëse në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 subjekti i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar *ex officio*, procesi duhet të ndërpritet *pa një vendim përfundimtar*, meqenëse marrëdhënia e punësimit ka përfunduar për arsye ligjore, si pasojë e një vendimi administrativ për largimin e tij nga detyra e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Ky vendim administrativ, vijon Komisioni, nuk përputhet me vullnetin e subjektit, është në fuqi dhe nuk ka asnjë formë ligjore nëpërmjet të cilës ai mund të ndryshohet apo të shfuqizohet. Subjekti i rivlerësimit e ka kontestuar atë në formë gjyqësore dhe gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë. Situata juridike dhe faktike nuk mund të konsiderohet si një dorëheqje. Subjekti i rivlerësimit ka humbur përfundimisht statusin e subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit të tij të mëparshëm, nga i cili u shkarkua, ndonëse është ende në sistem për shkak të emërimit nga Kuvendi në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (një ngjarjeje të mëvonshme ligjore nga Kuvendi). Për pasojë, në vlerësim të Komisionit, zbatimi i nenit G të Aneksit të Kushtetutës do të ishte joproporcional.

9.1 Komisioneri Publik ka ankimuar vendimin e mësipërm të Komisionit, duke potencuar se arsyetimi dhe vendimmarrja e Komisionit nuk gjejnë mbështetje në ligj, në jurisprudencën e Kolegjit dhe as në rrethanat faktike të rastit konkret. Argumentet e Komisionerit Publik kryesisht përqendrohen në dy drejtime. *Së pari*, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar më datë 22.07.2016, subjekti i rivlerësimit bënte pjesë në rrethin e personave të cilët i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit kalimtar *ex-officio*, për shkak të funksionit të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, në vijim të parashikimeve të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, e konkretisht vendimeve (JR) nr. 5/2021 dhe (JR) nr. 39/2020 [që i përkasin subjekteve të rivlerësimit E. Q. dhe E. K.], Komisioneri Publik parashtroi që, ndonëse në momentin kur Komisioni zhvilloi procesin subjekti i rivlerësimit nuk e ushtronte detyrën në fjalë, ai nuk e kishte humbur këtë status e procesi i rivlerësimit ndaj tij mund të përfundohej me rivlerësimin e tri kritereve ose të ndërpritej për shkak të vullnetit të tij.

9.2 *Së dyti*, pasi ka sjellë në vëmendje kronologjinë e veprimeve procedurale të ndodhura në periudhën kohore të ndërmjetme nga vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për subjektin me Gjykatën e Lartë deri në zhvillimin e procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni, Komisioneri Publik potencon se arsyetimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e subjektit të rivlerësimit, si pasojë e *një akti që ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij*, bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjin dhe nuk përputhet as me përmbajtjen e akteve në fashikull. Po ashtu, vendimmarrja e Komisionit, duke referuar e zbatuar normën e përgjithshme dhe përfundimin e procesit *pa vendim*, sipas parashikimit të nenit 95 të Kodit të Procedurës Administrative³, është e pabazuar në kushtet që ekziston parashikimi *i posaçëm*, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe rregullimeve të ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionerit Publik,

nëpërmjet të cilës përcillet përgjigja me të njëjtën datë e Kryetares së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtave të Njeriut, një kërkesë dërguar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

³ Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, përcakton: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative *pa një vendim përfundimtar për çështjen*, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Komisioni duhet të kishte marrë një vendim përfundimtar, duke zbatuar nenin G të Aneksit të Kushtetutës e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit duhet të ndalohej nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, pasi veprimet e tij – duke abstraguat nga fakti nëse urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë ishte i vlefshëm -- janë shprehje e qartë dhe e lirë e vullnetit të tij për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtat e tij dhe shprehur vullnetin e pavesur për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, duke bërë edhe një zgjedhje personale, që *ispo jure* nënkupton të shoqërohet me ndalimin që parashikon neni G i Aneksit të Kushtetutës.

9.3 Komisioneri Publik parashtron se Komisioni kishte kompetencën për të konstatuar se efektet e urdhrit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë [nr. {***}, datë 31.07.2017], nëpërmjet të cilit përfundoi marrëdhënia e punësimit e subjektit të rivlerësimit si ndihmës ligjor, është zhvillim paralel dhe pa peshë kundrejt cilësisë së fituar në mënyrë të shprehur në parashikimin e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, për përfshirjen e ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë, ndër të tjerë, në rrethin e personave të cilët i nënshtroreshin procesit të rivlerësimit kalimtar. Komisioneri Publik vlerëson se Komisioni mundej, qoftë edhe kryesisht në mënyrë incidentale, të konstatonte që efektet e këtij urdhri *nuk* ndikonin në ecurinë e procesit të rivlerësimit të subjektit, në kushtet kur: (i) z. Alfred Balla kishte statusin e padiskutueshëm të subjektit të rivlerësimit; (ii) Kushtetuta dhe ligji ia kishin njohur vazhdimësinë në detyrë ndihmësve/këshilltarëve ligjorë, duke rregulluar procedurat dhe përcaktuar organet përgjegjëse, të ndryshme nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, për karrierën e tyre; (iii) vetë subjekti i rivlerësimit, në interpretim të ligjit, argumentonte se gëzonte statusin e këshilltarit ligjor dhe kishte shfaqur interesin për të vijuar më tej të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë; (iv) kontrolli gjyqësor i iniciuar prej vetë subjektit kishte konstatuar moscenimin e statutit të ndihmësit ligjor nga aktet absolutisht të pavlefshme të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

9.4 Duke referuar jurisprudencën e Kolegjit, mbi zbatimin në kushte specifike të ndalimit që parashikon neni G i Aneksit të Kushtetutës për të gjitha kategoritë e funksionarëve të sistemit të drejtësisë, sipas Komisionerit Publik, vazhdimi i procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit ishte parakusht i padiskutueshëm edhe për shkak të detyrës së ushtruar prej tij në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”), një nga organet më të larta kushtetuese, për anëtarësinë në të cilin ndërprerja e procesit të rivlerësimit parashikohet si pengesë ligjore për emërimin për një periudhë 15-vjeçare. Komisioneri Publik ka theksuar se ndan qëndrim të njëjtë me Vëzhguesin Ndërkombëtar të ONM-së, në mendimin/opinionin me shkrim të administruar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 06.06.2022.

9.5 *Së fundmi*, Komisioneri Publik ka theksuar se të gjitha veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin e rivlerësimit përbëjnë heqje dorë nga procesi i rivlerësimit. Në këto veprime, përfshihen heqja dorë nga e drejta e padisë së paraqitur për gjykim në juridiksionin gjyqësor administrativ, heqja dorë nga kërkesa për njohjen/pasjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë paraqitur pranë KLGj-së, depozitimi në Komision i vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe rrëzimin e padisë, si dhe ai i KLGj-së për heqjen dorë nga kërkesa, sikurse edhe aktet ku subjekti i rivlerësimit bazonte kërkesën e tij për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9.6 Përkundër ankimit të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 675, datë 16.06.2023, të Komisionit, duke e cilësuar atë të drejtë të mbështetur në rrethanat faktike dhe në shkaqet ligjore. Në mbështetje të qëndrimit të tij, subjekti i rivlerësimit potencoi faktin që nuk gëzonte statusin e ndihmësit/këshilltarit ligjor dhe Komisioni nuk kishte një vendim të gjykatës apo organeve përkatëse, si KLGj-ja, lidhur me vijimin e këtij statusi. Nga ana tjetër, në kushtet kur ai ushtronte detyrën e anëtarit/kryetarit të KLP-së, i zgjedhur nga kandidatët jomagjistratë, nuk ishte në juridiksionin e Komisionit të kryente rivlerësimin e tij, sikurse ndodhte për anëtarët prokurorë/magjistratë të këtij Këshilli. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar drejt për moszbatimin e ndalimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Si ndihmës ligjor i Gjykatës së Lartë, ai ka dorëzuar në kohë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe nuk ka paraqitur asnjë akt për t'u larguar me vullnet nga detyra. Largimi i tij nga detyra është bërë në bazë të urdhrit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili është një akt administrativ. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk ka paraqitur asnjë akt dorëheqje në lidhje me procesin e rivlerësimit ndërkohë që i është nënshtruar një kontrolli tjetër të organeve kushtetuese dhe është zgjedhur anëtar i KLP-së nga radhët e jomagjistratëve. Akti administrativ i lirimit të tij nga detyra si ndihmës ligjor është prapësuar në rrugë gjyqësore, si akt administrativ i pavlefshëm.

9.7 Subjekti vijon pretendimet e tij se ndryshe nga sa parashtrohet në ankim rasti në shqyrtim nuk është i njëjtë me ato të referuara, por përkon me rastet dhe praktikën e Komisionit për përfundim të procesit pa vendim përfundimtar, të cilat nuk janë kundërshtuar nga Komisioneri Publik. Subjekti potencon që Vëzhguesi Ndërkombëtar nuk ka dhënë një opinion të kundërt apo rekomandim për të bërë ankim Komisioneri Publik. Urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë i ka dhënë pasojat e tij në ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për të cilën subjekti i rivlerësimit kishte fituar këtë cilësi. Me zgjedhjen në KLP, subjekti nuk ka më statusin e ndihmësit ligjor e, për pasojë, nuk ka vend për dyshim se subjekti po kryente veprime për shmangie të një kontrolli tjetër. Heqja dorë nga e drejta e padisë, kryer pasi i janë rrëzuar kërkesat e paraqitura për pezullimin e procesit të rivlerësimit në Komision, ka për efekt vetëm cenimin e të drejtave të tij për shkak të mospranimit të tyre. Çdo interpretim i kërkesave të parashtruara prej tij gjatë procesit administrativ, si shprehje e qartë dhe e lirë e vullnetit për t'iu shmangur procesit të rivlerësimit, do të ishte abuziv dhe joligjor.

10. Pasi shqyrtoi aktet në fashikujt e Komisionit, ankimin dhe pretendimet e palëve gjatë procesit gjyqësor publik të zhvilluar në praninë e tyre, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se pretendimet e Komisionerit Publik janë të bazuara. Vendimi objekt ankimi i Komisionit është i pabazuar dhe duhet të ndryshohet. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë gjithë ngjarjet procedurale që rezultojnë nga aktet në fashikujt e administruar të analizuara nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore. Nga ky vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se për subjektin e rivlerësimit duhet zbatuar ndalimi i përcaktuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës. Analiza harmonike e veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit përgjatë harkut kohor nga përfundimi i marrëdhënies së punës në Gjykatën e Lartë e deri në procesin gjyqësor të zhvilluar në Kolegj dëshmon vullnet të pavesuar të tij e zgjedhje të kryera për të mos iu nënshtruar procesit të rivlerësimit. Në këto kushte dhe në linjë me vendime të mëparshme të Kolegjit për çështje të ngjashme, subjekti ka shfaqur vullnetin me

veprime konkludente, të cilat në thelb përbëjnë pa ekuivok heqje dorë nga procesi i rivlerësimit/dorëheqje gjatë procesit.

10.1. Konkluzionin e mësipërm, përpos kërimit të shprehur e përsëritur të subjektit të rivlerësimit në Komision dhe në Kolegj, për të mos iu nënshtroar rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit e mbajti në konsideratë edhe sa rezulton nga aktet, si aspekte më rëndësi parësore në një analizë rigoroze të situatës ligjore e faktike.

10.2. Në parantezë e si premisë e domosdoshme e arsytimit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit e gëzon këtë cilësi, pasi ka ushtruar detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë për mbi pesë (5) vjet e konkretisht në periudhën kohore 02.04.2012 - 31.07.2017. Për rrjedhojë, ai bën pjesë në rrethin e individëve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, nën dritën e pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës⁴ dhe është subjekt rivlerësimi, në kuptim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 165, pikat 1 dhe 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”).

10.3 Së dyti, e duke iu rikthyer rrethanave faktike konkrete, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje veprimet që rezultojnë nga aktet në fashikull:

a. Me urdhrin [nr. {***}, datë 31.07.2017] e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, subjekti është liruar nga detyra e ndihmësit ligjor *për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit të asaj gjykate, pranë të cilit punonte subjekti i rivlerësimit*. Marrëdhëniet financiare të këtij urdhri kanë përfunduar më datë 15 shtator 2017.

b. Në datën 08 shkurt 2018, subjekti i rivlerësimit është zgjedhur anëtar i KLP-së, si përfaqësues i *shoqërisë civile*.

c. Në datën 22 qershor 2018, katër muaj më pas, subjekti i ka kërkuar Komisionit ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për të, duke u shprehur se *procesi i vetting-ut nuk i nevojitet* meqenëse *nuk ishte* më ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, sepse *nuk e konsideronte veten subjekt të ligjit nr. 84/2016*, për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i KLP-së.

d. Ndryshe nga sa ka argumentuar në korrespondencën e sipërcituar me Komisionin në qershor të vitit 2018, në shtator të vitit 2020 – rreth dy vite më pas -- subjekti i rivlerësimit ka kontestuar urdhrin e lirimit nga detyra si ndihmës ligjor në një proces gjyqësor⁵. Në kërkesëpadinë e ngritur kundër Gjykatës së Lartë, ai kërkonte: “*Detyrimin e palës së paditur t’i njohë të drejtën e rikthimit [...] në pozicionin e këshilltarit jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, pas mbarimit të mandatit të anëtarit të KLP-së, për shkak se kishte statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor në momentin e emërimit në KLP [...]*”. Në kërkesëpadi, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: “[...]”

⁴ “[4.] Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*. Procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet.[...]”.

⁵ Fillimisht subjekti rezulton ta ketë ngritur padinë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 15.09.2020. Kjo gjykatë ka shpallur mungesë kompetence lëndore dhe ia ka kaluar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin që mban datën 16.03.2021.

për shkak të detyrës që ushtronte, në bazë të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës është subjekt rivlerësimi ex officio [...]”⁶.

e. Në datën 23 dhjetor 2020, KLGj-ja ka vendosur⁷ të pezullojë shqyrtimin e një kërkesë të mëparshme të subjektit të rivlerësimit për njohjen e statusit të ndihmësit ligjor *jomagjistrat* pranë Gjykatës së Lartë. Vendimi në fjalë referon se kërkesa tashmë ishte bërë objekt i një shqyrtimi gjyqësor.

f. Në datën 12 dhjetor 2021, Komisioni organizoi shortin për caktimin e trupit gjykues për rivlerësimin e subjektit *ex-officio*. Dy kërkesa të tjera të subjektit për pezullim të procesit të rivlerësimit deri kur vendimi i gjykatës⁸ do të merrte formë të prerë, paraqitur përkatësisht në nëntor e dhjetor 2022, nuk u pranuan [referuar edhe në vijim].

g. Subjekti i ktheu përgjigje pyetësorit standard, dërguar në datën 09 nëntor 2022, duke u shprehur edhe se rezervonte të drejtën të përcillte plotësime të përgjigjeve në varësi të verifikimeve që do të kryente⁹.

h. Në periudhën e ndërmjetme, mes caktimit të trupit gjykues dhe dërgimit të pyetësorit nr. 2 [më 3 mars 2023], vëzhguesi ndërkombëtar ka depozituar *tre* opinione me shkrim¹⁰, përkatësisht në datat 6 qershor 2022, 26 janar 2023 dhe 31 janar 2023. Këto tre akte potencojnë disa argumente ligjore relevante kundrejt zhvillimeve në ndërveprimet e subjektit me Komisionin. Konkretisht, vëzhguesi argumenton se fitimi i cilësisë si subjekt rivlerësimi ishte derivat i detyrës së cilën ai kryente *në momentin e hyrjes në fuqi* të kuadrit kushtetues e ligjor të rivlerësimit, pa qenë e kushtëzuar [kjo cilësi] nga ngjarje apo zhvillime të karrierës së tij në vijim. Në mendimin/opinionin e dytë vëzhguesi argumenton se shkresa e titulluar “ankim”¹¹, paraqitur nga subjekti, për të kundërshtuar vendimin për vijimin e procesit të rivlerësimit për të, nuk parashikohet shprehimisht si i pranueshëm nga ligji. Vëzhguesi potencon vlerësimin që kjo kërkesë të refuzohet sipas ligjit nga Komisioni dhe të mos dërgojë dosjen në Kolegj për shqyrtim, për të shmangur vonesa të panevojshme. *Së fundmi*, në mendimin/opinionin e tretë, vëzhguesi parashtrohet nevojën për kryerjen e veprimeve hetimore konkrete, për të vijuar me vlerësimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit.

i. Pyetësori tjetër [nr. 2] daton tre muaj më pas, më 03 mars 2023. Subjekti nuk rezulton t’i ketë kthyer përgjigje këtyre pyetjeve, edhe pasi i është dërguar një kujtesë së bashku me zgjatje dyjavore afati të pakërkuar prej tij, deri më 03.04.2023.

j. Ndonëse subjekti nuk kishte dhënë përgjigje dhe as shprehur pamundësi apo njoftuar se kishte nevojë për kohë shtesë, pas 12 ditësh, në datën 15.03.2023, Komisioni rezulton t’ia ketë zgjatur

⁶ Sipas vendimit nr. {***} ({***}), datë 29.07.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

⁷ Me vendimin nr. {***}.

⁸ Vendimi i referuar në poshtëshënimin nr. 6, më sipër që pranoi kërkesëpadinë e subjektit pjesërisht dhe urdhëroi pagesën e dëmit të shkaktuar paditësit nëpërmjet shlyerjes së pagave për periudhën kohore 16.06.2017 - 14.02.2018, respektivisht nga ndërprerja e marrëdhënies financiare me Gjykatën e Lartë deri në emërimin si anëtar i KLP-së. Vendimi u ankimua nga të dy palët.

⁹ Sipas e-mail-it të tij dërguar Komisionit në datën 30.11.2022.

¹⁰ Në zbatim të nenit 49, pikat 10 e 11 të ligjit nr. 84/2016.

¹¹ Subjekti rezulton të ketë ushtruar ankim në datën 24.01.2023 kundër një vendimi të ndërmjetëm të Komisionit, që mban datën 16.01.2023, nëpërmjet të cilit Komisioni vendosi mospranimin e kërkesës së tij për pezullimin e procesit të rivlerësimit. Referuar edhe më sipër në këtë paragraf, në nënpikën “f”.

afatin subjektit vetë, *a proprio motu*, deri në datën 03.04.2023, për t'iu përgjigjur pyetësorit nr. 2. Koha shitesë e caktuar me iniciativë të Komisionit ka përkuar me finalizimin e disa veprimeve procedurale të ndërmarra prej subjektit, të cilat kurorëzojnë me sukses përpjekjet e mësipërme të tij për shmangie nga procesi i rivlerësimit kalimtar, nëpërmjet procedimit në gjykatë dhe vënies në lëvizje të KLGj-së, të cilat vlerësohen të kenë rezultuar me ndikim vendimtar në mënyrën sesi Komisioni e ka zgjidhur çështjen e rivlerësimit të subjektit me vendimin objekt ankimi.

k. Konkretisht, në datën 24 mars 2023, subjekti rezulton të ketë pasur dijeni të vendimit të marrë nga Gjykata Administrative e Apelit 14 ditë më herët, për një proces të ankimuar edhe prej tij. Nëpërmjet këtij vendimi, *për shkak të heqjes dorë* së atij vetë nga padia, u disponua me prishjen e vendimit të shkallës së parë [referuar në nënpikën “d” më sipër]. Vendimi i shkallës së parë, nga i cili subjekti kishte rezultuar gjyqfitues, i njihte subjektit *statusin* e ndihmësit ligjor *jomagjistrat* deri në momentin e zgjedhjes si anëtar i KLP-së, kur me vullnetin e tij ka hequr dorë nga çdo e drejtë që buronte prej tij.

l. Në të njëjtën datë, më 24 mars 2023, subjekti ka hequr dorë edhe nga një kërkesë e mëhershme nëpërmjet të cilës ka angazhuar edhe KLGj-në në procesin e njohjes së statusit të tij si ndihmës ligjor jomagjistrat, proces që më pas është pezulluar, pasi subjekti e kishte adresuar këtë çështje nëpërmjet padisë në gjykatë mbi bazën e të cilës është vendosur për pezullimin e vendimmarrjes¹², në pritje të procesit gjyqësor të nisur prej tij.

m. Në datën 04 prill 2023, në korrespondencën me Komisionin, duke parashtruar ngjarjet procedurale të iniciuara e referuara më sipër, që u kurorëzuan me konfirmimin e KLGj-së për humbjen e statusit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se procesi i rivlerësimit ndaj tij ishte *i kundërligjshëm* dhe *pa asnjë motiv* ligjor, administrativ apo *moral që të vazhdohej ndaj një përfaqësuesi të një organi Kushtetues*. Subjekti ka bashkëlidhur edhe vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe kërkesën e dërguar prej tij KLGj-së për të hequr dorë nga kërkesa e mëparshme për njohjen e statusit të ndihmësit ligjor [referuar më sipër].

n. Në datën 30.05.2023, subjekti i ka dërguar Komisionit edhe vendimin e KLGj-së, datë 24.05.2023, nëpërmjet të cilit disponohej për përfundimin *pa* një vendim përfundimtar të procedurës së nisur me kërkesën e tij për njohjen e statusit të ndihmësit ligjor *jomagjistrat*. Përfundimi i kësaj procedure edhe nga KLGj-ja referohet i bazuar në heqjen dorë nga kërkuesi/subjekti i rivlerësimit.

o. Në të njëjtën datë, më 30 maj 2023, Komisioni i dërgoi subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat referohej qëndrimi sipas së cilit procesi i rivlerësimit për të duhet të deklarohej i përfunduar *pa* një vendim përfundimtar dhe e ftoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti shprehu dakordësinë me këtë qëndrim të Komisionit dhe që nuk do dëshironte të njihej me prova e as të merrte pjesë në seancë. Me vendimin objekt ankimi, në datën 16.06.2023, Komisioni vendosi të përfundojë procedurën *pa* një vendim përfundimtar, me arsyetimin se z. Alfred Balla i kishte humbur statusi i subjektit të rivlerësimit për një arsye ligjore, që ishte urdhri për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, vazhdimësia e të cilit [statusit] u bë e pamundur për

¹² Për njohjen e statusit të ndihmësit ligjor, referuar në nënpikën “e” dhe poshtëshënimin nr. 6.

shkak të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit e, për rrjedhojë, nuk ishte më subjekt i ligjit nr. 84/2016 dhe procesi duhej të përfundohej.

11. Nga aktet e përmbledhura më sipër, rezultojnë disa rrethana ligjore e faktike që marrin peshë përcaktuese në analizën e veprimeve të subjektit në kontekstin e *vullnetit* të tij për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, të kontekstit ligjor që paraqet urdhri i lirimit të tij nga detyra, sikurse edhe për sa i përket panoramës më të gjerë të mënyrës sesi subjekti ka zgjedhur ta trajtojë situatën ligjore, ndërkohë që ishte pjesë e një institucioni të organeve qeverisëse të sistemit të drejtësisë, mbajtës i një prej pozicioneve të referuara nominalisht edhe nga neni G i Aneksit të Kushtetutës, për shkak të rëndësisë që ai paraqet.

11.1. *Së pari*, nga aktet e referuara më sipër rezultojnë qartë të ndjekura nga subjekti dy linja paralele/të ndryshme qëndrimesh, në dy drejtime të ndryshme institucionale. Konkretisht, ndërsa në komunikimet e hershme me Komisionin subjekti ka potencuar me forcë qëndrimin se për të nuk duhet të kryhej rivlerësimi – meqenëse ishte anëtar i KLP-së – në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ai ka pretenduar të kundërtën, edhe dy vite më pas, duke argumentuar në mënyrë konsistente, jo vetëm i ish-in cenuar të drejtat financiare të pagës deri në marrjen e detyrës në KLP, por edhe gëzonte ende statusin e ndihmësit ligjor, detyrë tek e cila duhet të kthehej pas mbarimit të mandatit në KLP dhe urdhri i lirimit nga detyra ishte absolutisht i pavlefshëm¹³. Padia e ngritur për këtë qëllim më 15.09.2020, dy vite pasi subjekti pa asnjë ekuivok i kërkonte Komisionit të mos i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, pasi procesi *nuk i nevojitej*, sepse ishte anëtar i KLP-së dhe e kishte humbur cilësinë e ndihmësit ligjor, dëshmon për qëndrime diametralisht të kundërta, që mund të bëjnë kuptim vetëm nëse shihen si përpjekje e subjektit për të pasqyruar rrethanat në funksion të objektivit në kërkimet përkatëse e jo si pasqyrim i saktë i *vullnetit* të tij. Këto kërkime, po ashtu, tregojnë përtej çdo ekuivoku që subjekti ishte i ndërgjegjshëm që urdhri i lirimit të tij nga detyra e ndihmësit ligjor nuk përputhej/binte ndesh me ligjin, por edhe anëtarësia në KLP ishte shkak vetëm për ta përjashtuar nga procesi i rivlerësimit, por jo nga të drejtat që buronin nga detyra që ai kryente në momentin kur hyri në fuqi kuadri kushtetues e ligjor i rivlerësimit e tek e cila kërkonte të rikthehej edhe në shtator 2021.

11.2. Subjekti e ka ankimuar vendimin e sipër referuar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 13.09.2021, për të vetmin aspekt të kërkesëpadisë që *nuk* i është pranuar, e konkretisht lidhur me kërkesën e tij për të urdhëruar të paditurin [Gjykatën e Lartë dhe KLGj-në] ta rikthenin në detyrën e ndihmësit ligjor në *mbarim* të detyrës në KLP. Nga kjo kërkesë dhe nga padia në tërësi ai rezulton të ketë hequr dorë vetëm në datën 13.02.2023, thuajse një vit e gjysmë më pas. Ky moment kohor përkon me stadin kur paralelisht subjekti ishte përpjekur sërish e pa sukses të ndërpresë procesin e rivlerësimit nëpërmjet kërkesave, si dhe kishte depozituar edhe një “ankim” në datën 24.01.2023, kundër një vendimi të ndërmjetëm të Komisioni për të vijuar me rivlerësimin e tij. Ky moment kohor, po ashtu, përkon me stadin kur tashmë vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes kishte depozituar në Komision edhe dy opinionet e fundit, përkatësisht në datat 24 dhe 31 janar 2023. Është domethënëse të theksohet që në kërkesën për heqjen dorë *tërësisht* nga padia e ngritur prej tij, pasi procesi gjyqësor po merrte një zgjidhje në shkallën e dytë, subjekti është shprehur se *statusi aktual nuk përputhet me atë të ndihmësit ligjor* nga i cili është

¹³ Referuar vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë datë 29.07.2021.

larguar në shtator 2017¹⁴. Me fjalë të tjera, vetëm një vit e gjysmë më pas, në shkurt 2023, subjekti rezulton të ketë rënë dakord me të vetmin argument ligjor të prapësimeve të palës kundërshtare, që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pranoi në procesin e iniciuar prej tij.

11.3. *E thënë ndryshe*, paralelisht me rivlerësimin, subjekti vijonte të pretendonte deri të paktën në shkurt 2023 se duhet të kthehej në detyrën e mëparshme pas mbarimit të mandatit, nuk kishte humbur të drejtat që i përkisnin si ish-ndihmës ligjor dhe i gëzonte këto të drejta pavarësisht se në KLP ishte zgjedhur nga *radhët e shoqërisë civile*. Kjo situatë, duket se përkon dhe vijon deri në momentin kur trupit gjykues të Komisionit i duhej të vijonte rivlerësimin për të, pasi kishte marrë dy opinione me shkrim nga vëzhguesi ndërkombëtar, në vijim të të cilave duhet të ndërmerre veprime konkrete, sipas përcaktimit të nenit 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016.

11.4. Nga analiza e mësipërme, në vlerësimin e trupit gjykues në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit, jo vetëm e ka gëzuar këtë cilësi në vijim, edhe pasi i është ndërprerë marrëdhënia e punës, por ka treguar nëpërmjet qëndrimeve në institucione se kishte për qëllim të rifitonte të drejtat më të cilat shoqërohej ajo detyrë, në të ardhmen e tij profesionale e në aspektin financiar. Nga veprimet dhe aktet e sipër referuara, rezulton se nga tërësia e attributeve me të cilat shoqërohej detyra e ndihmësit ligjor në momentin kur ka hyrë në fuqi sistemi i rivlerësimit, subjekti ka qenë i interesuar të gëzonte të drejtat me të cilat ajo shoqërohej. E kundërta rezulton për detyrimin/përgjegjësinë për të ruajtur këtë detyrë nëpërmjet rivlerësimit, nga e cila subjekti është përprjekur e ka treguar si rrjedhojë vullnet të qartë të shmangej. Subjekti rezulton të ketë paraqitur një qëndrim nga i cili deduktohet se ai nuk ka pasur më vullnet të kthehet në gjyqësor, duke filluar nga shkurti 2023, nëpërmjet tërheqjes nga e drejta e padisë. Deri në këtë moment në kohë, nga veprimet e kryera në kontestin gjyqësor, aktet tregojnë vullnetin e tij të qartë për t'u rikthyer në sistemin e drejtësisë. Nga ana tjetër dhe si pjesë e së njëjtës panoramë, nga ndërveprimet e tij me institucionet e rivlerësimit, rezulton e qartë se subjekti nuk kishte asnjë vullnet për t'iu nënshtruar rivlerësimit. E thënë me fjalë të tjera, subjekti ka treguar me vullnet të pavesuar dëshirën për të qëndruar në sistemin e drejtësisë, por duke anashkaluar detyrimin ligjor për të kaluar me sukses rivlerësimin që ishte parakusht për të, për shkak të detyrës së mëparshme. Për rrjedhojë, është e pamundur të argumentohet se subjekti i rivlerësimit hoqi dorë nga të drejtat që i burojnë nga statusi i ndihmësit/këshilltarit ligjor [në Gjykatën e Lartë] nga ngjarje që nuk varehin prej tij.

11.5. *Së dyti*, trupi gjykues analizoi nëse marrëdhënia e punës e subjektit të rivlerësimit në Gjykatën e Lartë është ndërprerë *për shkaqe ligjore*, përcaktuar si një ndër kriteret përjashtuese nga neni 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Ky hap është parakusht për vlerësimin e veprimeve të ndërmarra prej subjektit, pasojë e të cilave ishte edhe emërimi në KLP. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, trupi gjykues konkludon se urdhri nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit është liruar nga detyra është nxjerrë në mungesë të kompetencës ligjore të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për shkak të rregullimeve ligjore të reja konstatuar edhe nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese¹⁵, të cilat mundësuan procesin e

¹⁴ Referuar në faqen 10 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, datë 10.03.2023.

¹⁵ Me ndryshimet e sjella nga ligji nr. 76/2016, pika 4 e nenit 179/b të Kushtetutës parashikon: "[4.] Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish

rivlerësimi kalimtar edhe për ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, ndër të tjerë, përfshirë edhe ata jomagjistratë¹⁶, shoqëruar njëkohësisht me kuadrin ligjor, i cili sanksiononte mundësi të zhvillimit të karrierës për ndihmësit ligjorë të rregulluara nën kompetencat e KLGj-së¹⁷, ishte ky i fundit organi kompetent, i cili do të vendoste për vijueshmërinë e marrëdhënies së punësimit të këshilltarëve e ndihmësve ligjorë.

11.6. Për këtë shkak, urdhri në fjalë rezulton të jetë nxjerrë, jo vetëm në mungesë të kompetencës së Kryetarit të Gjykatës së Lartë, por edhe në shkelje të garancive që jepte ligji për vijueshmërinë e marrëdhënies së punës për ndihmësit ligjorë. Këto dy aspekte bashkërisht përbëjnë defekte të atilla të aktit administrativ që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute të tij në kuptim të nenit 108, germa “a”, pika “i” e ligjit¹⁸ nr. 44/2015. Si i tillë, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike e konsiderohet se nuk ekziston, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë¹⁹.

11.7. Po ashtu, urdhri i lirimit nga detyra e ndihmësit ligjor, disa muaj pasi kishin hyrë në fuqi dispozitat e sipër referuara, pavarësisht nga krijimi i mëpasmë i KLGj-së, nuk mund të argumentohet se përbën arsyen ligjore që parashikon pika 2 e nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, e cila legjitimon mosvijimin e qëndrimit në detyrë për subjektin e rivlerësimit apo për përjashtimin e tij nga detyrimet për rivlerësimin. Ky ka qenë në fakt edhe interpretimi i parashtruar në mënyrë konsistente prej subjektit përgjatë gjithë procesit gjyqësor të iniciuar prej tij.

11.8. Trupi gjykues mban në konsideratë se kronologjia e fakteve të renditura më lart dhe analiza e kryer në drejtim të vullnetit të subjektit të rivlerësimit në proces nuk afekton e as cenon të drejtën e subjektit për punë, si një e drejtë themelore e çdo individ. Është zgjedhja e bërë prej tij për të qenë pjesë e një organi kushtetues, e cila passillte pasjen e një statusi ligjor që ishte i papajftueshmë me të mëparshmin, duke hequr dorë prej gëzimit të të drejtave që buronin nga statusi i këshilltarit ligjor, që u vlerësua në këtë kontekst si sjellje e vullnetshme që synon rritjen në karrierë *brenda sistemit* të drejtësisë, të cilën një subjekt rivlerësimi, në frymën e qëllimit të procesit të rivlerësimit, legjitimohet ta kryejë vetëm pasi ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Rivlerësimi është proces i ndryshëm kontrolli nga çdo proces që kryhet nga organe të tjera kushtetuese. Kjo zgjedhje e bërë me vullnet të lirë dhe mbështetur në të drejtën e çdo individ për të ushtruar profesionin e tij është e rëndësishme në këtë analizë vetëm për sa ajo lidhet me vijimin ose jo të procesit të rivlerësimit.

prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet. [...]”.

¹⁶ Ligji nr. 96/2016, neni 165, pikat 1 dhe 2 parashikojnë: “1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, [...] që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin [...]. 2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. [...]”.

¹⁷ Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 34, pika 5 parashikon: “[5.] Këshilltarët ligjorë jomagjistratë emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas rregullave të 12 parashikuara në këtë ligj. [...]”, ndërsa neni 84, pika 4 parashikon: “[4.] Ndihmësi ligjor magjistrat dhe këshilltari/ndihmësi ligjor jomagjistrat janë subjekt i dispozitave kalimtare të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

¹⁸ “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; [...]”.

¹⁹ Neni 110, pika 1 e të njëjtit ligj.

11.9. Në këtë linjë arsyetimi, deduktohet si rrjedhojë edhe që subjekti i rivlerësimit nuk mund të humbte statusin e ndihmësit ligjor për shkak të këtij urdhri. Humbja e statusit ka ndodhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit në kushtet kur, ndërsa fillimisht [për mbi tre vjet] subjekti zgjodhi të mos e kontestojë lirimin nga detyra në rrugë ligjore, ka shfaqur vullnetin për t'u zgjedhur anëtar në një organ tjetër kushtetues. Kjo sjellje e subjektit përbën shkakun determinant për përfundimin e marrëdhënies së punës së subjektit si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë dhe u vlerësua se përmbush kushtet për t'u kualifikuar si dorëheqje nga detyra, në kuptimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, referuar edhe trajtimit të situatave të ngjashme nga Kolegji në jurisprudencën e tij²⁰.

11.10. Për rrjedhojë, nga analiza harmonike e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, rezulton se pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Vullneti i potencuar pa asnjë ekuivok në komunikimet me organet e rivlerësimit për të mos iu nënshtruar procesit, meqenëse nuk e kryente më detyrën nga e cila buronte detyrimi për t'iu nënshtruar këtij procesi, së bashku me veprimet e kryera nga subjekti paralel e në institucione të tjera, dëshmojnë që subjekti ishte i vetëdijshëm për të drejtat që derivonin nga legjislacioni për statusin si këshilltar ligjor, sikurse edhe detyrimin për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit. Për të njëjtin arsyetim, analizuar në harmoni me mundësitë që ofronte legjislacioni për subjektet të cilët dëshirojnë të vijnë në jenë pjesë e sistemit të drejtësisë, u vlerësuan nga trupi gjykues si veprime të subjektit që përbëjnë në thelb heqje dorë nga detyra që e bënte subjekt rivlerësimi *ex officio*.

11.11. Në këtë kontekst, referuar edhe orientimeve të Kolegjit për mënyrën sesi duhet të analizohet situata faktike dhe ligjore, si parakusht për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, kundrejt përmbushjes së kriterëve që passjellin zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, mungesa e një akti formal të shprehjes së vullnetit për dorëheqje nga detyra, në rrethanat konkrete, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga pasojat e asaj dispozite. Në kushtet që me vullnet të pavesuar, subjekti, jo vetëm nuk e kontestoi në kohën e duhur urdhrin për lirimin nga detyra dhe kërkoi marrjen e një detyre tjetër, por edhe hoqi dorë nga padia për konstatimin e pavlefshëm të urdhrin të lirim nga detyra, megjithëse ky konstatim ishte bërë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në një moment kohor, i cili përkon me avancimin e hetimit administrativ në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar nëpërmjet pyetësorëve dhe depozitimit të disa gjetjeve dhe opinioneve të Vëzhguesit Ndërkombëtar, vlerësohet nga trupi gjykues si një zgjedhje e subjektit që konfirmon vullnetin e tij për të humbur statusin e ndihmësit ligjor, që e bënte atë subjekt rivlerësimi *ex officio*.

11.12. Për sa më lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfunduar në kuptimin ligjor marrëdhënien e punësimit si këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë për shkak të vullnetit të tij, ka kërkuar të mos i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, edhe ndërsa ai vetë ka pretenduar gjyqësisht se e gëzonte statusin e këshilltarit ligjor që e bënte atë subjekt rivlerësimi dhe, më pas, ka hequr dorë nga pretendimi i këtyre të drejtave në funksion të mosnënshtrimin ndaj këtij procesi, rrethana të cilat përfaqësojnë një situatë të kualifikueshme sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

²⁰ Çështja e subjektit të rivlerësimit O. Xh., sipas vendimit të Kolegjit (JR) nr. 35/2023, në https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/12/Vendim_Ornela_Xhembulla_anonimizuar.pdf.

12. Përfundimisht, trupi gjykues, bazuar në analizën e mësipërme, e gjen të drejtë ankimin e Komisionerit Publik, duke konkluduar se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi nr. 675, datë 16.06.2023, është i pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet ndryshuar, duke u zbatuar në këtë rast neni G i Aneksit të Kushtetutës, me ndalimet përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe në germën “b”, të pikës 1, të neni 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 675, datë 16.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si më poshtë:
 - Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Alfred Balla.
 - Subjekti i rivlerësimit Alfred Balla nuk mund të emërohet si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.05.2024.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi-kundër

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi-kundër

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 675, datë 16.06.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Alfred Balla, nëpërmjet të cilit është vendosur ndryshimi i vendimit të mësipërm të Komisionit, duke ndërprerë procesin e rivlerësimit për këtë subjekt si dhe ndalimin e emërimit të tij për një periudhë 15-vjeçare në detyrat e parashikuara në paragrafin 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.
2. Subjekti i rivlerësimit Alfred Balla, në kohën e hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim “ligji nr. 76/2016”), ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ishte i emëruar në detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, procesi i rivlerësimit ndaj këtij subjekti ka nisur *ex officio* në përputhje me parashikimet kushtetuese e ligjore, ndërsa procedura administrative për kryerjen e këtij procesi ka filluar me hedhjen e shortit nga Komisioni në datën 12.02.2021.
3. Në kohën që nisi procedura administrative për kryerjen e procesit të rivlerësimit ndaj subjektit, konstatohet se z. Balla ishte në ushtrim të detyrës së anëtarit të KLP-së²¹, i zgjedhur me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, datë 08.02.2018. Në këtë detyrë, z. Balla është zgjedhur si përfaqësues i shoqërisë civile, pasi ka kaluar të gjitha fazat e verifikimit të kandidaturës së tij, sipas parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim “ligji nr. 115/2016”).
Z. Alfred Balla ishte liruar nga detyra e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, si pasojë e urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për shkak të përfundimit të afatit të kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të gjyqtarit A. M.. Largimi përfundimtar nga detyra ishte në datën 15.09.2017.
Në datën 15.09.2020, rreth 5 muaj përpara hedhjes së shortit për fillimin e procedurës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: *detyrimin e palës së paditur Gjykata e Lartë, t'i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmës ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë atë në detyrë, si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë; detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë paditësit pagën nga data 16.09.2017-19.12.2018 (ditë e konstituimit të KLP-së); [...].*
Me vendimin nr. {***}, datë 16.03.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarin e moskompetencës lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje dhe kalimin e akteve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Çështja është regjistruar pranë kësaj gjykate më datë 26.04.2021.

²¹ KLP-ja u konstituua në datën 19.12.2018.

Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. {***}({***}), datë 29.07.2021, ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë; detyrimin e palës së paditur, Gjykatës së Lartë, që t’i paguajë paditësit dëmin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës në masën e pagesës për periudhën 16.09.2017-14.02.2018; rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj; shpenzimet gjyqësore në masën 1/2 i ngarkohen palës së paditur, Gjykatës së Lartë”*. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim, subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata e Lartë.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar ankimin pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, më datë 13.09.2021, ndërsa më datë 13.02.2023, ai ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesën me objekt: *“Për heqje dorë tërësisht nga e drejta e padisë”*, me pretendimin se bazuar në nenin 201/a të Kodit të Procedurës Civile, paraqet këtë kërkesë, pasi statusi i tij aktual pranë KLP-së nuk përputhet me atë të ndihmësit ligjor, nga i cili ishte larguar në shtator 2017.

Me vendimin nr. {***}, datë 10.03.2023, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. {***}({***}), datë 29.07.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë*. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë është nënshkruar rregullisht nga pala paditëse Alfred Balla. Në këtë kërkesë rezultoi i treguar qartë nga ana e palës paditëse, vullneti i saj për të hequr dorë tërësisht nga e drejta e padisë në çështjen objekt gjykimi. [...] për rrjedhojë, bazuar në këtë kërkesë, gjykata do të disponojë me prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. [...] Sipas nenit 201/a të Kodit të Procedurës Civile, në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi, pra, jemi përpara një vendimi përfundimtar me efektet e gjësë së gjykuar, në kuptimin që paditësi nuk mund të ngrejë më padi me këto lloj kërkesesh në të ardhmen*.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. {***}, datë 24.05.2023, ka vendosur: *“Përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat të z. Alfred Balla, për shkak të heqjes dorë”*, pasi subjekti i rivlerësimit më datë 24.03.2023 kishte paraqitur pranë këtij Këshilli kërkesën për heqje dorë nga njohja/pasja e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, pas marrjes së vendimit nga Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë.

4. Në analizë të situatës faktike të konstatuar si më sipër, si rezultat i arsyetimit dhe disponimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë²², si më sipërcituar, rezultoi se urdhri nr. {***}, datë 31.07.2017, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, *“Për lirimin nga detyra”* të z. Alfred Balla, nuk është ndryshuar apo shfuqizuar, për pasojë ka mbetur në fuqi, me të gjitha pasojat që ai ka sjellë ndaj subjektit të rivlerësimit, që në datën 15.09.2017, në drejtim të largimit të tij nga detyra dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës e marrëdhënieve financiare [që buronin prej saj], me Gjykatën e Lartë.

Neni 165 me titull *“Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë”*, i ligjit nr. 96/2016, në pikat 1 dhe 2 parashikon: *“1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë e*

²² Nga burime zyrtare të hapura, konkretisht nga kërkimi në faqen zyrtare në internet të Gjykatës së Lartë, rezultoi se ndaj vendimit nr. {***}, datë 10.03.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nuk është ushtruar rekurs.

Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekt i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. 2.Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga kjo analizë, rezulton se në datën 26.06.2023, në të cilën është marrë vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit kishte humbur statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor në bazë të urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për shkak të përfundimit të afatit të kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ai kishte punuar. Kam vlerësuar se ky urdhër ka shkaktuar edhe mbarimin e këtij statusi për subjektin e rivlerësimit, i cili nuk rezulton të jetë shfuqizuar si rezultat i një vendimi të marrë në rrugë gjyqësore apo administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

Në këto kushte, konsiderohet se marrëdhënia e punës së subjektit të rivlerësimit si këshilltar/ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë ka përfunduar për arsye ligjore, në kuptim të pikës 2, të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016. Situata faktike, e cila i është nënshtruar vlerësimit të Komisionit, nuk ka pasur asnjë paqartësi në drejtim të faktit se subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e ndihmësit ligjor dhe asnjë çështje nuk gjendej në ndonjë gjykatë kompetente, për të zgjidhur ndonjë pretendim rreth kësaj situate.

Për sa u arsyetua më lart, kam konkluduar se në kohën e marrjes së vendimit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e këshilltarit/ndihmësit ligjor, dhe kjo ishte e vetmja rrethanë që duhej të vlerësohej nga Kolegji në marrjen e vendimit për procesin e tij të rivlerësimit.

5. Pretendimi i Komisionerit Publik, në ankim, i mbështetur edhe nga shumica, se Komisioni mundej, qoftë edhe kryesisht në mënyrë *incidentale*, të konstatonte pasojat e vlefshmërisë së urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, të lirimit nga detyra e ndihmësit ligjor të subjektit, jo në raport me marrëdhënien e punës, por në raport me ecurinë e procesit të rivlerësimit dhe efektet mbi statusin e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi, kam vlerësuar se është i pambështetur në dispozitat procedurale që përcaktojnë kufijtë dhe fushën e kontrollit të organeve të rivlerësimit. Nëse është i vlefshëm ose jo ky urdhër, nuk është çështje e juridiksionit dhe kompetencës së organeve të rivlerësimit. Në kuptim të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, në kuadër edhe të jurisprudencës së Kolegjit, i rëndësishëm është vlerësimi nëse në kohën e marrjes prej Komisionit të vendimit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit e kishte humbur statusin e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, pasi ajo që organet e rivlerësimit kanë në kompetencën e tyre është pikërisht kryerja e procesit për subjektet e përcaktuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, përveç rasteve kur statusi i tyre ka mbaruar për arsye ligjore apo me dorëheqje të shprehur apo të heshtur të subjekteve.

Pavarësisht qëndrimit të mësipërm, në vijim të pretendimit të Komisionerit Publik për konsiderimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit të nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, për lirimin nga detyra të z. Balla, për shkak të përfundimit të afatit të kontratës së punës, kam vlerësuar ndryshe nga shumica, duke konkluduar se ky akt është nxjerrë nga organi kompetent në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Sipas pikës 2 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, këshilltarët e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, ***vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.***

Kjo dispozitë e ligjit duket se ka pasur për qëllim që të rregullojë se cili do të jetë ligji i kohës që do të zbatohet për marrëdhëniet e punës së këshilltarëve/ndihmësave ligjorë të Gjykatës së Lartë gjatë periudhës tranzitore nga mbarimi i veprimit të ligjit të vjetër dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Marrëdhëniet e punës së këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 98/2016”), rregulloheshin në bazë të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”²³ [në vijim “ligji nr. 8588/2000”] dhe vendimit unifikues nr. 5/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke i konsideruar ato si marrëdhënie pune me kohëzgjatje të caktuar [me afat]. Sipas përcaktimeve të këtij ligji këshilltarët/ndihmësat ligjorë të Gjykatës së Lartë kishin një marrëdhënie pune me afat sa mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit, me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ata ishin caktuar të ushtronin detyrën. Në vlerësimin tim, neni 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, nuk e ka ndryshuar këtë regjim duke qenë se në përmbajtjen e tij përcaktohet se këshilltarët ligjorë ***vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit.*** Kjo dispozitë ka përcaktuar se vazhdimësia e qëndrimit në detyrë e këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë do të vijonte deri në përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit të tyre kalimtar, me përjashtim të rastit kur: (i) marrëdhënia e tyre e punës përfundon për arsye ligjore; ose (ii) subjekti nuk arrin të kalojë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Pra, kjo dispozitë ka parashikuar se qëndrimi në detyrë i këshilltarit ligjor do të rregullohej në përputhje me përcaktimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilat parashikonin se marrëdhënia e tyre e punës ishte me kohëzgjatje/afat të caktuar. Në interpretim të nenit 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, kam vlerësuar se për këshilltarët/ndihmësat ligjorë, të cilët ligji nr. 96/2016 dhe ligji nr. 98/2016 i gjeti në detyrë, ligji që duhej të zbatohet për arsyet ligjore të përfundimit të marrëdhënieve të tyre të punës ishte ligji i vjetër, pra, ligji nr. 8588/2000. Gjithashtu, kam vlerësuar se këshilltarit/ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë nuk i është dhënë statusi i nëpunësit civil gjyqësor me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016 dhe ligjit nr. 98/2016, pasi për të përfituar këtë status ata bazuar në nenin 165, pika 9 e ligjit nr. 96/2016, si dhe nenit 84, pika 4 e ligjit nr. 98/2016, ata duhet të kalonin me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, kam çmuar se Kryetari i Gjykatës së Lartë në rastin e z. Balla nuk ka zgjidhur marrëdhënien e punës para afatit për shkak të vlerësimit të tij për shkaqe/rrethana, të cilat përligjinin zgjidhjen e marrëdhënies së punës, sipas nenit 7, germa “ç” e ligjit nr. 8588/2000 dhe Kodit të Punës [për çështje të cilat nuk gjenin rregullim në ligjin e posaçëm], por ai ka

²³ Ligj i shfuqizuar.

konstatuar faktin e përfundimit të saj në mënyrë natyrale, në zbatim të përcaktimeve të nenit 165, pika 2 dhe ligjit nr. 8588/2000, pra, duke përfunduar këtë marrëdhënie për shkak të ligjit.

Në konkluzion të sa më sipër, ndryshe nga shumica kam konkluduar që urdhri i nxjerr nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, për lirimin nga detyra të z. Balla, nuk është një akt absolutisht i pavlefshëm, por ai është nxjerrë nga organi kompetent në përputhje me ligjin e kohës që rregullonte marrëdhënien e tij të punës, dhe konkretisht ligjin nr. 8588/2000.

Duket se interpretimi e qëndrimi i mësipërm i arsyetuar prej meje si gjyqtare në pakicë, lidhur me vlefshmërinë e aktit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ka gjetur një interpretim të njëjtë edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. {***} Vendimi ({***}), datë 16.07.2024, me palë paditëse znj. A. G. dhe të paditur Gjykatën e Lartë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ky vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka pasur paditëse një këshilltare/ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, marrëdhëniet e punës së të cilës kanë përfunduar me një akt të Kryetarit të Gjykatës së Lartë në datën 06.10.2017, pasi gjyqtarit pranë të cilit ushtronte detyrën i kishte përfunduar mandati, pra, në një situatë faktike të njëjtë me z. Alfred Balla. Edhe pse ky vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është marrë pas vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, referimi i tij në këtë mendim pakice paraqitet për të mbështetur sa është arsyetuar më sipër në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Sipas këtij vendimi [...] *parimi i vazhdimësisë institucionale në lidhje me marrëdhënien e punës së këshilltarëve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë deri në kohën e përfundimit me sukses të procesit të rivlerësimit të tyre kalimtar, i referohet asaj kategorie punonjësi që, megjithëse marrëdhëniet e punës ishte krijuar në zbatim të ligjit nr. 8588/2000, si një marrëdhënie pune me afat të caktuar, ngushtësisht e lidhur me kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, kjo marrëdhënie vijonte dhe nuk kishte përfunduar referuar afatit, për shkak të vijimit të mandatit të gjyqtarit edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016*²⁴. Më tej, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konkluduar se: [...] *marrëdhëniet e punës së palës paditëse në kohën e nxjerrjes së urdhrit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë (06.10.2026) kishte përfunduar për shkak të përfundimit të mandatit kushtetues të gjyqtarit z. A. Ç., pasi përfundimi i afatit kontraktor të kontratës së punës për vijimin e marrëdhënies së punës përbën një shkak të arsyeshëm dhe të ligjshëm të përfundimit të marrëdhënies së punës gjatë periudhës tranzitore dhe të përkohshme të qëndrimit në detyrë të ndihmësve ligjor. Kolegji çmon të ligjshëm përfundimin e arritur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë se kontrata e punës së paditëses A. G. konsiderohet me afat të caktuar, për shkak të kufizimit në kohë të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë*²⁵.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka konsideruar aktin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë si një akt: [...] *me natyrë deklarative dhe nuk përbën një vendim shkarkimi të ndihmësit ligjor (në kuptim të nenit 7, germa “ç” të ligjit nr. 8588/2000), por një vendim me efekt konstatues për përfundimin e afatit të kontratës së punës, për shkak të përmbushjes së afatit kontraktor të marrëdhënies së punës që, në përputhje me kontratën e punës nr. {***} prot., datë 07.04.2015, përfundonte me mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë pranë të cilit këshilltari ofronte shërbimet ligjore. Ndaj Kolegji çmon të ligjshëm përfundimin e marrëdhënies së punës së*

²⁴ Paragrafi 40 i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

²⁵ Paragrafi 41 i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

*palës paditëse nisur nga situata faktike dhe ligjore që ajo ndodhej në kohën e shkëputjes së marrëdhënies së punës*²⁶.

Sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se vlerësimi i urdhrit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, lidhur me marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit, si ndihmës ligjor, është paralel dhe, për pasojë, pa asnjë peshë mbi faktin që subjekti i rivlerësimit e kishte fituar këtë cilësi në mënyrë të shprehur në parashikimin e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe Komisioni kishte kompetencën për të konstatuar se efektet e urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nuk ndikonin në ecurinë e procesit të rivlerësimit të subjektit, në ndryshim nga shumica, kam vlerësuar se ky pretendim i Komisionerit vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme. Në vendimin nr. 32/2021 (JR), Kolegji ka arsyetuar se: *13.12 Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje, Kolegji, duke përdorur si bazë konkluzionin e arritur më sipër, lidhur me humbjen e statusit të magjistratit prej subjektit, shqyrtoi legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret dhe, sipas kësaj analize, konkludoi se procesi i rivlerësimit nuk mund të vazhdojë për një subjekt rivlerësimi që nuk e gëzon më këtë status në momentin e dhënies së vendimit.*

[...].13.13 Në vijim të këtij arsytimi dhe në konsideratë të situatës faktike, Kolegji shqyrtoi dhe analizoi vendimin e Komisionit në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, dhe nga kjo analizë nuk konstatoi shkeljen e asnjë prej tyre. Subjekti i rivlerësimit I. H. e ka fituar statusin e magjistratit në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, dispozita të cilat e lidhin pasjen e këtij statusi me pasjen e statusit të magjistratit, si edhe përcaktojnë zhvillimin e procesit të rivlerësimit ex officio për këtë kategori. Humbja e statusit të magjistratit me vendim të formës së prerë të organit kompetent, kushtëzon edhe humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit sipas dispozitave të cituara, e për pasojë rrëzon vetë objektin e procesit të rivlerësimit i cili synon rivlerësimin e subjekteve sipas kategorizimit të më lart cituar.

Në çështjen e z. Alfred Balla, në vijim të arsytimit e qëndrimit të mësipërm, lidhur me ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e aktit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë për lirimin e tij nga detyra, kam vlerësuar se organi kompetent kishte nxjerrë aktin për humbjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor, pra, tashmë z. Balla nuk ishte subjekt rivlerësimi e, për pasojë, procesi i rivlerësimit ka humbur objektin dhe qëllimin e tij.

6. Në ankim, Komisioneri Publik ka pretenduar se *legjislacioni që normon procesin e rivlerësimit parashikon qartësisht se nëse subjektet vendosin të mos i nënshtrohen këtij procesi, atëherë ata përjashtohen nga mundësia e emërimit në disa prej organeve të drejtësisë, për një periudhë 15-vjeçare, sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.*

Në vijim të arsytimit të bërë më sipër, kam vlerësuar se urdhri nr. {***}, datë 31.07.2017, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për lirimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas së cilit ky i fundit që nga data 15.09.2017 nuk mund të ushtronte më detyrën si këshilltar ligjor pranë kësaj gjykate, ka sjellë si pasojë edhe humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi, bazuar në parashikimet e pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit,

²⁶ Paragrafi 42 i vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

përfundimisht, realizohet nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Humbja e statusit të subjektit të rivlerësimit, sipas dispozitave të sipërcituara, rrëzon për pasojë vetë objektin e procesit të rivlerësimit. Në përfundim, kam arritur në konkluzionin se humbja e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor është një rrethanë që kushtëzon procesin e tij të rivlerësimit, i cili mbetet në këtë rast pa një objekt, sipas përcaktimit të legjislacionit të cituar më lart.

Ky konkluzion mban në konsideratë edhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit²⁷ në rastet kur subjektet e rivlerësimit kanë humbur statusin e magjistratit për shkaqe/arsye ligjore [mbushjen e moshës së pensionit të pleqërisë] dhe kam vlerësuar se organi kompetent kishte nxjerrë aktin për humbjen e statusit të këshilltarit ligjor, pra, tashmë z. Balla nuk ishte subjekt rivlerësimi e, për pasojë, procesi i rivlerësimit ka humbur objektin dhe qëllimin e tij.

Në këtë kuadër, vendimi i Komisionit, i cili në mungesë të një rregullimi të posaçëm në ligjin nr. 84/2016, për zgjidhjen e një situatë të tillë dhe në zbatim të dispozitave referuese që përcakton neni 4, pika 6 i të njëjtit ligj, ka aplikuar nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, është gjetur prej meje i drejtë për zgjidhjen ligjore të situatës faktike.

Largimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit nuk erdhi për shkak të vullnetit të tij apo për shkak të veprimeve të tjera të kryera prej tij, por erdhi si pasojë e një akti administrativ, sipas së cilit shkaku/arsyeja ligjore e lirimit nga detyra ishte përfundimi i afatit të kontratës së punës. Urdhri nr. {***}, datë 31.07.2017, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për lirim nga detyra e ndihmësit ligjor, z. Alfred Balla, i ka dhënë pasojat pavarësisht dëshirës apo vullnetit të subjektit të rivlerësimit. Ky fakt nuk mund të barazohet kurrësi me dorëheqjen nga detyra, e cila nënkupton largimin/heqjen dorë nga detyra me vullnetin e shprehur të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor, nuk gjendet asnjë akt që të provojë se z. Alfred Balla ka dhënë dorëheqjen nga detyra e këshilltarit/ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, nuk rezulton që z. Balla të ketë paraqitur një kërkesë për t'u punësuar në një detyrë tjetër, ndërkohë që ishte duke ushtruar detyrën e këshilltarit/ndihmësit ligjorë apo të ketë pranuar me veprime konkludente kryerjen e një detyre tjetër, ndërkohë që nuk kishte një akt nga organi kompetent për përfundimin e marrëdhënies së punës si këshilltar/ndihmës ligjor, çka do të nënkuptonte që me veprime konkludente kishte shprehur vullnetin për të mos vijuar ushtrimin e detyrës së këshilltarit/ndihmësit ligjorë.

7. Edhe aplikimi për pozicionin kushtetues të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile është bërë nga z. Balla, më datë 30.11.2017, në kohën që nuk ishte në marrëdhënie pune, pasi ishte larguar nga detyra e këshilltarit/ndihmësit ligjorë në Gjykatën e Lartë, për shkak të mbarimit të afatit të kontratës së punës, në datën 15.09.2017, në ushtrim të së drejtës së njohur në nenin 49 të Kushtetutës, për të zgjedhur lirisht punën e tij. Arsyetimi i shumicës në paragrafin 11.8 të vendimit se zgjedhja e bërë prej z. Balla për të qenë pjesë e një organi kushtetues, *passillte pasjen e një statusi ligjor që ishte i papajtueshëm me të mëparshmin*, kam çmuar se është në kapërcim të kompetencave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi legjislacioni në fuqi ka

²⁷ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 55/2023 (JR), datë 20.12.2023 dhe nr.22/2024 (JR), datë 14.05.2024.

përcaktuar në ligjin nr. 115/2016, cili është organi që verifikon dhe konkludon lidhur me një situatë papajtueshmërie në ushtrimin e detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë [në vijim KLP]. Nga ana tjetër të pretendosh që z. Balla në momentin e aplikimit për anëtar i KLP-së ishte ende këshilltar ligjor i Gjykatës së Lartë, përveçse është një qëndrim i bazuar në një interpretim të gabuar të ligjit²⁸ është në vlerësim të gabuar edhe të situatës faktike, pasi jo vetëm *de jure*, por edhe me veprime konkludente ai nuk vazhdonte të ofronte shërbimet si këshilltar/ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu, kam kundërshtuar qëndrimin e shumicës në vendim se aplikimi i z. Balla për anëtar i KLP-së, në vetvete *është heqje dore nga statusi i këshilltarit ligjor dhe shprehje vullneti për karrierë në sistem të cilën një subjekt rivlerësimi në frymën e qëllimit të procesit të rivlerësimit, legjitimohet ta kryejë vetëm pasi ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar*, në vijim të qëndrimit të më sipërrasyetuar, pra, që urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë ishte i ligjshëm dhe pas kësaj ai kishte të drejtën për punë për të garantuar mjetet e jetesës për të dhe familjen e tij. Në ndryshim nga çështje të tjera të trajtuara në Kolegj²⁹, në të cilat subjektet e rivlerësimit kanë paraqitur dorëheqje nga detyra e këshilltarit ligjor apo me veprime konkludente kanë shprehur vullnetin për të marrë një detyrë të re e më pas kanë përfunduar marrëdhënien e punës së këshilltarit ligjor, z. Alfred Balla, në momentin e aplikimit i kishte përfunduar në mënyrë natyrale për arsye ligjore marrëdhënia e punës si këshilltar ligjor. Në këto kushte, ai kishte të drejtën të aplikonte për punë në përputhje me eksperiencën e tij profesionale. Për më tepër, kam vlerësuar si joproporcional kufizimin e artikulluar nga shumica në paragrafin 11.8 të vendimit, sa i përket njohjes së të drejtës për punë vetëm pasi z. Balla të kishte kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, edhe pse individ/ish-subjekt rivlerësimi ishte pa mjete jetese. Me pak fjalë, të kërkoj nga një individ, i cili *de jure* dhe *de facto* është pa punë dhe pa të ardhura për të jetuar, të mos ushtrojë të drejtën për punë deri sa të mbarojë procesi i rivlerësimit [përndryshe do të konsiderohej se kishte shprehur vullnet për të ndërprerë procesin e rivlerësimit], në vlerësimin tim, përveçse është një interpretim i zgjeruar i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, është një kufizim i të drejtës për punë të njohur në nenin 49 të Kushtetutës.

Në këtë linjë arsyetimi, në momentin që subjekti i rivlerësimit nuk ka vendosur me vullnetin e tij të lirë të largohej nga detyra e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, që e bënte atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, kam vlerësuar se ai nuk gjendet në kushtet e dorëheqjes nga detyra, për rrjedhojë nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe si rezultat pasoja juridike, që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në këtë nen, nuk mund të zbatohet në tërësinë e saj. Sa më sipër, kam gjetur të drejtë arsyetimin e Komisionit në vendim³⁰ se: *“Ajo që organet kanë tagër, është pikërisht kryerja e procesit për subjektet e ligjit, përveç rasteve kur statusi mbaron për arsye ligjore apo me dorëheqje të shprehur apo të heshtur të subjekteve. [...] “Arsyet ligjore” të identifikuara në këtë mënyrë nuk mund të konsiderohen si një listë shteruese, por Komisioni si organ rivlerësimi është i detyruar ligjërisht t’i vlerësojë ato sipas veçorive të rastit konkret, mbi të gjitha kur nuk është e mundur të*

²⁸ Nenit 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, ligjit nr. 98/2016 dhe ligjit nr. 8588/2000, si më sipër është interpretuar në këtë mendim pakice.

²⁹ Vendimi i Kolegjit nr. 17/2019 (JR), datë 25.07.2019 dhe vendimi nr. 16/2023 (JR), datë 19.04.2023.

³⁰ Paragrafët 22.5 dhe 22.6 të vendimit të Komisionit.

identifikohet vullneti i shprehur ose i heshtur i një subjekti rivlerësimi për të dhënë dorëheqjen - sepse kjo mund të konsiderohet si joproporcionale”.

8. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se Komisioni, ashtu sikurse Kolegji ka vepruar në jurisprudencën e tij, i mbetej dhe duhej të verifikonte vullnetin e subjektit për të mos iu shmangur dhe përfunduar procesin e rivlerësimit, duke përfshirë këtu të gjitha veprimet e kryera prej subjektit të rivlerësimit lidhur me procesin e rivlerësimit, përfshirë edhe vetë heqjen dorë nga e drejta e padisë së paraqitur për gjykim prej tij, përpara juridiksionit gjyqësor administrativ, si dhe heqjen dorë nga kërkesa për njohjen/pasjen e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë paraqitur në KLGj, depozitimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe rrëzimin e padisë, si dhe ai i KLGj-së për heqjen dorë nga kërkesa, si aktet ku subjekti i rivlerësimit bazonte kërkesën e tij për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, ndryshe nga shumica, kam vlerësuar se këto akte nuk mund të konsiderohen si shprehje e vullnetit të pavesuar për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.
9. Subjekti i rivlerësimit, fillimisht, i është drejtuar Komisionit me “Kërkesë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit fillestar”, e regjistruar me nr. {***} prot., datë 22.06.2018, në të cilën, ndër të tjera, shprehet se: *“Në bazë të dispozitave të paketës ligjore të reformës në drejtësi të vitit 2016, unë nuk e kam pasur dhe nuk e kam statusin e magjistratit (gjyqtar ose prokuror). I vetmi benefit i ofruar për ne nga ligji ishte se këtë status mund ta fitoja nëse do t'i nënshtrohesha provimit të Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e ish-ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë e, pasi të kualifikohesha, të ndiqja një vit studim pranë kësaj shkolle. Këtë të drejtë unë nuk e shfrytëzoja, pasi nuk kisha interes dhe në datën 08.02.2018, me vendim nr. {***}, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, jam zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile. Gjatë procedurës së kandidimit tim, pranë organit kushtetues të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kam qenë subjekt i kontrollit të figurës, anës profesionale dhe pasurisë sime nga organet e caktuara me ligj [...]. Duke pasur parasysh qëllimin e ligjit për rivlerësimin kalimtar, që ka për objekt kontrollin për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë aktualisht në detyrë, vlerësoj se unë nuk jam më subjekt i kontrollit, sipas ligjit nr. 84/2016, ndaj procedura e rivlerësimit kalimtar (vetting-ut) ndaj meje duhet ndërprerë [...]”.*

Pasi është njoftuar nga Komisioni për nisjen e procesit të tij të rivlerësimit, në komunikimin nëpërmjet postës elektronike, me e-mail të datës 10.01.2022, subjekti ka kërkuar ndërprerjen e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, duke pretenduar, ndër të tjera, se: *“Duke menduar se u lirova jashtë dëshirës sime nga detyra dhe procedura e vetting-ut tim kishte përfunduar, në datën 22.06.2018 i jam drejtuar me shkresë KPK-së ku kam kërkuar ndërprerjen e kësaj procedure (pa vendim përfundimtar, pasi ka rënë objekti). Nuk kam marrë deri më sot asnjë përgjigje për këtë procedurë të iniciuar nga ana ime. Pas tre vitesh nga largimi nga detyra për të testuar problemin juridik të ruajtjes apo jo të statusit juridik të ndihmësit ligjor, duke parë një praktikë të KLGj-së (ishte disi ndryshe pasi personi nuk u shkëput nga detyra), vendosa të ndjek rrugën ligjore të gjyqit dhe të drejtuarit kërkesë KLGj-së për statusin e pretenduar. [...] ka një procedurë të pezulluar nga një organ tjetër kushtetues, sikundër është KLGj-ja në lidhje me faktin nëse e kam ruajtur apo humbur statusin e ndihmësit ligjor. [...] nëse do vazhdojë procesi i vetting-ut tim dhe unë nuk kam asnjë status për çfarë do më duhet gjithë ky angazhim profesional e administrativ qoftë imi edhe juaji si organe me ngarkesë maksimale për momentin”.*

Në datën 14.01.2022, Komisioni i njofton subjektin të rivlerësimit një vendim të marrë në datën 26.10.2021, mbi shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti në datën 22.06.2018, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj tij. Në këtë vendim, Komisioni ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ndodhet para një rasti dorëheqjeje nga detyra, në kuptim të nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vijueshmëria e procesit ndaj subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i pozitës së tij do të duhej të realizohej nga një trup gjykues i shortuar, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

Komisioni (trupi gjykues i shortuar), pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit, lidhur me procesin e rivlerësimit të tij, në datën 09.11.2022, vendosi për vijimin e procesit të rivlerësimit për z. Alfred Balla, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se në analizë të nenit 165, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 96/2016, z. Balla duhet t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, pasi ai gëzonte "statusin e subjektit të ligjit". Sipas Komisionit, në kushtet kur z. Balla e kishte bërë objekt të një procesi gjyqësor vendimin e lirimit nga detyra si këshilltar ligjor, në të cilin gjykata ka pranuar vetëm rregullimin e pasojave financiare të tij, **ky vendim nuk mund të konsiderohej në këtë fazë të procesit si një vendim i cili sjell si pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për arsye ligjore, siç kërkohet nga neni 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.**

Në komunikimin, me anë të postës elektronike për njoftimin e vendimmarrjes së sipërcituar, Komisioni i ka kërkuar subjektin që në vijim të procesit të rivlerësimit t'i përgjigjet pyetësorit standard, brenda datës 23.11.2022. Subjekti i rivlerësimit, me e-mail-in e datës 30.11.2022, e ka kthyer të plotësuar pyetësorin standard, të dërguar nga ana e Komisionit.

Në vijim të komunikimeve me Komisionin, me e-mail-in e datës 12.12.2022 dhe kërkesën e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 14.12.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar të tij deri në përfundimin e procesit gjyqësor dhe daljen e gjykatës me një vendim të formës së prerë, lidhur me çështjen e pasjes ose jo nga ana e tij të statusit të këshilltarit të Gjykatës së Lartë.

Komisioni, me e-mail të datës 16.01.2023, ka njoftuar subjektin se ka vendosur mospranimin e kërkesës së tij, për pezullimin e procedurës së rivlerësimit kalimtar të tij dhe me arsyetimin e kësaj vendimmarrjeje do të njihet në vendimin përfundimtar. Në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni ka referuar se në datën 19.12.2022, mori vendim për mospranimin e kërkesës dhe vijimin e procesit të rivlerësimit, duke arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se: *Është e qartë, por edhe detyrim ligjor për një organ administrativ që, kur vijueshmëria e tij varet nga një vendimmarrje tjetër, qoftë kjo edhe gjyqësore, të vlerësojë pezullimin ose jo të procesit administrativ, derisa vendimmarrja tjetër të përfundojë. Në rastin konkret, duke qenë se veprimtaria e organeve të rivlerësimit është e kufizuar në kohë dhe nisur nga fakti se juridiksioni i posaçëm i organeve të rivlerësimit ka të bëjë me procesin në vetvete, trupi gjykues çmoi mospezullimin e procesit dhe vijimin e tij. Trupi gjykues gjithashtu çmoi se në kushtet kur ky proces do të vijojë me një vendimmarrje të caktuar, ai do të rivlerësojë përsëri rrethanat faktike dhe ligjore. Në këtë rast, ajo që prevaloi ishte interesi publik për shmangien e vonesave në kryerjen e procesit të rivlerësimit.*

Ndaj vendimit të sipërcituar, për mospranimin e kërkesës për pezullimin e procesit të rivlerësimit, subjekti depozitoi një ankim në Komision, mbi të cilin ky i fundit, me vendimin nr. 4, datë 30.01.2023, vendosi mospranimin e ankimit të subjektit të rivlerësimit, me arsyetimin se ankimi është bërë ndaj një vendimi ndaj të cilit nuk mund të bëhet ankim.

Komisioni, në vijim të procedurave standarde të procesit të rivlerësimit, më datë 23.11.2022, i dërgoi subjektit pyetësorin standard lidhur me vlerësimin e pasurisë, të cilit ai iu përgjigj në rrugë elektronike më datë 30.11.2022, si dhe më datë 03.03.2023, i dërgoi pyetësorin nr. 2, duke i kërkuar subjektit kthimin e përgjigjeve brenda datës 15.03.2023. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së Komisionit, ky i fundit i ka drejtuar edhe dy e-mail të tjerë subjektit, përkatësisht në datat 20.03.2023 dhe 29.03.2023, për t'i sjellë në vëmendje detyrimin ligjor për kthimin e përgjigjeve të drejtuara me anë të pyetësorit nr. 2.

10. Në vijim, subjekti i rivlerësimit, me shkresën e regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.04.2023, i ka vënë në dispozicion Komisionit: vendimin nr. {***}, datë 10.03.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. {***} ({***}), datë 29.07.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë”*, pas depozitimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, më datë 03.03.2023, nga subjekti i rivlerësimit të kërkesës për heqje dore nga e drejta e padisë, në të cilën ai pretendonte se statusi aktual si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk përputhej me atë të ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë; si dhe kërkesën e paraqitur prej tij në KLGj, më datë 24.03.2023, për heqje dorë nga kërkesa për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë.

Në kërkesën e paraqitur në Komision, subjekti ka pretenduar se aktet e paraqitura prej tij, të cituara më sipër, së bashku me vendimin që KLGj-ja do të merrte shumë shpejt mbi kërkesën e tij, hidhnin dritë mbi dyshimet e Komisionit se mos ai gëzonte ose do të gëzonte në të ardhmen ndonjë status të ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Sipas subjektit, tashmë nuk kishte asnjë motiv ligjor, administrativ apo dhe moral që ndaj tij të vazhdonte procesi i rivlerësimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. {***}, datë 24.05.2023, vendosi: *“Përfundimin pa vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat të z. Alfred Balla, për shkak të heqjes dorë”*, pasi subjekti i rivlerësimit më datë 24.03.2023 kishte paraqitur pranë këtij Këshilli kërkesën për heqje dorë nga njohja/pasja e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Komisioni, më datë 30.05.2023, i ka përcjellë subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ, duke konstatuar se: *[...] duket se në rastin konkret jemi para zbatimit të nenit 103 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “1. Procedimi administrativ përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur. 2. Deklarimi i përfundimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë gjithnjë i arsyetuar dhe kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë [...]*, si dhe i kërkoj subjektit t'i vërë në dijeni nëse do të marrë pjesë apo jo në seancë dëgjimore, lidhur me procesin e tij të rivlerësimit. Më tej, në vendimin përfundimtar, Komisioni ka marrë vendimin objekt shqyrtimi.

11. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik dhe situatës faktike të përshkruar më sipër, kam vlerësuar se me rëndësi të posaçme në procesin e rivlerësimit është sjellja e subjektit kundrejt këtij procesi. Në rastin konkret, sjellja dhe vullneti i subjektit lidhen ngushtësisht me faktin e pamohueshëm se ai nuk ishte duke ushtruar detyrën e këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, në momentin e marrjes së vendimit objekt shqyrtimi nga Komisionit, madje as në momentin e hedhjes së shortit për fillimin e procedurës të rivlerësimit ndaj tij në datën 12.02.2021, pasi ishte

liruar nga detyra me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për arsyen ligjore të përfundimit të afatit të kontratës së punës në mbarim të mandatit të gjyqtarit pranë të cilit ai ushtronte detyrën. Vetë subjekti, në interpretim të nenit 165, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, ka kuptuar se nuk e gëzonte statusin e ndihmësit ligjor, për shkak të lirimit nga kjo detyrë, ashtu siç është shprehur edhe në kërkesat drejtuar Komisionit për pezullimin/ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ndaj tij. Madje, për këtë arsye, subjekti nuk ka marrë pjesë as në testimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës në datat 7 dhe 8 maj 2018³¹. Lirimi nga detyra nuk ka qenë një zgjedhje personale e subjektit të rivlerësimit, por ajo ka ardhur për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij, për pasojë ai nuk ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor që nga data 15.09.2017.

Vënia në lëvizje e procesit gjyqësor rreth 5 muaj përpara hedhjes së shortit për fillimin e procedurës së rivlerësimit, me paraqitjen e kërkesë padisë në datën 15.09.2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt detyrimin e palës së paditur Gjykata e Lartë, t'i njohë paditësit statusin e këshilltarit/ndihmës ligjor jomagjistrat në Gjykatën e Lartë e të rikthejë atë në detyrë, si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, është një e drejtë që i përket kujtdo që pretendon se i janë shkelur të drejtat. Në rastin konkret, subjekti i ka deklaruar Komisionit se i është drejtuar gjykatës me padi *për të testuar problemin juridik të ruajtjes apo jo të statusit juridik të ndihmësit ligjor*, e cila lidhej me pretendimin e tij për të ruajtur këtë status pas përfundimit të mandatit si anëtar i KLP-së, siç rezulton nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Arsyetimi i kësaj gjykate, i cili renditet si një nga argumentet e shumicës [edhe pse ky vendim është prishur me vendim të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë], në mbështetje të qëndrimit se subjekti i rivlerësimit gëzonte statusin e këshilltarit/ndihmës ligjor, e kam vlerësuar si jorelevant për zgjidhjen e çështjes, pasi arsyetimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në vendimin nr. {***} ({***}), datë 29.07.2021, lidhet drejtpërdrejtë me objektin e padisë së ngritur nga subjekti i rivlerësimit/paditësi për t'i njohur të drejtën e rikthimit në pozicionin e këshilltarit jomagjistrat në Gjykatën e Lartë, pas mbarimit të mandatit të anëtarit të KLP-së, si dhe të deklaramentit se lirimi i paditësit nga detyra ka ndodhur pa shkaqe të ligjshme, duke përcaktuar rregullimin e pasojave vetëm në drejtim të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar paditësit dhe nuk kishte si qëllim përcaktimin e pozicionit të paditësit si subjekt rivlerësimi në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar. Pretendimet e ngritura nga paditësi në këtë proces gjyqësor, pra, nga z. Balla, se atij i kishin përfunduar marrëdhëniet e punës pa shkaqe të ligjshme, nuk mund të shndërrohen në procesin e rivlerësimit, si argumente të cilat mbështesin/provojnë se në subkoshiençën e tij, ai vlerësonte se ishte ende këshilltar/ndihmës ligjor, për rrjedhojë edhe subjekt rivlerësimi në këtë proces.

12. Në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik se aktet/vendimet gjyqësore, ku subjekti i rivlerësimit bazonte kërkesën e tij për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, janë shprehje e qartë dhe e lirë e vullnetit të tij për t'iu shmangur kryerjes së procesit të rivlerësimit është me rëndësi të evidentohet nën dritën e situatës faktike se subjekti kërkesën e parë për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit e ka depozituar në Komision që në datën 22.06.2018, rreth dy vite përpara vënies në lëvizje të procesit gjyqësor, si rezultat i të cilit janë prodhuar vendimet gjyqësore të sipërcituara. Argumenti bazë dhe konsekuent i përdorur nga subjekti i rivlerësimit në

³¹ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 18.06.2018, lëshuar subjektit nga Shkolla e Magjistraturës.

kërkesat drejtuar Komisionit për përfundimin e procesit të rivlerësimit të tij ka qenë mospasja e statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, për shkak të liritimit nga detyra në vitin 2017, për arsye ligjore.

Më tej, heqja dorë e subjektit nga e drejta e padisë është një zgjedhje personale, për të hequr dorë nga zgjidhja e së drejtës së pretenduar se i është shkelur, por ajo kurrësi nuk mund të barazohet me një dorëheqje nga detyra apo me vullnetin për të hequr dorë nga detyra e, aq më tepër, me vullnet për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit. Subjekti edhe pse kishte kërkuar që të ndërpritej/përfundonte procesi i rivlerësimit ndaj tij iu përgjigj pyetësorit standard të drejtuar nga Komisioni. Kërkesat e subjektit për ndërprerjen/përfundimin e procesit të rivlerësimit të nisur ndaj tij janë mbështetur në situatën faktike në të cilën ai gjendej në raport me kuadrin ligjor të zbatueshëm.

Në interpretim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, aplikimi i ndalimit të parashikuar në të lidhet fillimisht me ekzistencën e aktit për dorëheqje nga detyra, jo vetëm në aspektin formal, por dhe në mënyrë të heshtur dhe më pas në këtë kuadër me verifikimin nëse akti i dorëheqjes ka ardhur për shkak të vullnetit të subjektit për t’iu shmangur procesit të rivlerësimit. Në rastin konkret, bazuar në sa më sipër u arsyetua, kam vlerësuar se mungon kushti fillestar i parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës – dorëheqja nga detyra e këshilltarit ligjor subjektit të rivlerësimit apo një kërkesë e tij apo edhe vullneti i tij i shprehur me veprime konkludente për t’u larguar nga detyra. Përkundrazi, arsyet e liritimit nga detyra kanë qenë tërësisht të pavarura nga vullneti i tij, si rrjedhojë e aktit të nxjerrë nga organi kompetent, sipas ligjit të kohës. Për rrjedhojë, përfundimisht, kam vlerësuar se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës për aplikimin e pasojës së parashikuar nga ky nen, ndaj vendimi i Komisionit ishte i drejtë, i bazuar në prova të ligj dhe, si i tillë, duhej të lihej në fuqi.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, për shqyrtimin e çështjes (JR) nr. 30/2023, datë 14.07.2023, kam votuar kundër vendimit të shumicës, i cili ka vendosur: *“[...] Subjekti i rivlerësimit Alfred Balla nuk mund të emërohet si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare”*.
2. Në cilësinë e gjyqtares në mendim pakice, vlerësoj se, për vetë specifikat e rastit konkret, duhen trajtuar tri momente kryesore: (i) nëse z. Balla ishte subjekt i rivlerësimit në momentin e hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese dhe ligjore në kuadër të procesit të rivlerësimit; (ii) pasojat ligjore dhe faktike të urdhrit nr. {***}, datë 31.07.2017, “Për lirim nga detyra”, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili përfundoi marrëdhënien e punësimit të subjektit të rivlerësimit si ndihmës ligjor; si dhe (iii) zbatueshmëria e ndalimit të parashikuar nga neni G i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në vijim, po parashtoj arsyetimin dhe vlerësimin tim lidhur me to:

3.1. Së pari, theksoj dakordësinë me anëtarët e trupit gjykues se në kohën e hyrjes në fuqi të dispozitave kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 76/2016”), ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), z. Balla ishte i emëruar në detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë dhe gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit, *ex officio*, bazuar në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës. Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të kuadrit ligjor të zbatueshëm ka dorëzuar pranë institucioneve kompetente deklaratën për vlerësimin e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin e aftësive profesionale.

3.2. Së dyti, gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu dhe në Kolegj, rezultoi e provuar se z. Balla, me urdhrin nr. {***}, datë 02.04.2012, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ishte emëruar në detyrën e ndihmësit ligjor pranë gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. A. M.. Z. Balla e ushtroi këtë detyrë për gati 5 vite dhe u lirua prej saj me urdhrin nr. {***}, datë 31.07.2017, “Për lirim nga detyra”, po të Kryetarit të kësaj gjykate, me motivacionin se ka përfunduar afati i kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ka punuar si ndihmës ligjor. Ky urdhër është bazuar në pikën 2 të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, si dhe urdhrin nr. {***}, datë 24.11.2014, “Për miratimin e strukturës organike dhe klasifikimin e vendeve të punës për personelin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

3.2.1. Nga analizimi i dispozitave ligjore të përdorura nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, në urdhrin për lirimin nga detyra të z. Balla, rezulton se neni 165 me titull “*Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë*”, i ligjit nr. 96/2016, në pikën 2 parashikon se: “*Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni (i.e. ndihmësit ligjorë) vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/20216 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe*

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në rastin objekt shqyrtimi, ligjvënësi ka shprehur qartë qëllimin e tij, kur ka përcaktuar me një dispozitë tranzitore trajtimin e situatës juridike të këshilltarëve ligjorë të Gjykatës së Lartë, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, duke përcaktuar dy mënyra për përfundimin e marrëdhënies së punës së tyre: (i) arsye ligjore; dhe (ii) moskalimin me sukses të procesit të rivlerësimit kalimtar.

3.2.2. Në referencë të këtyre parashikimeve ligjore, ndihmësit ligjorë qëndronin në detyrë në përputhje me kuadrin legjislativ, që ishte në fuqi përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, sipas dispozitave të ligjit organik nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”. Marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor të Gjykatës së Lartë është trajtuar qartësisht dhe në vendimin unifikues nr. 5, datë 22.01.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është mbajtur ky qëndrim: “*Ndihmësi ligjor i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë e ushtron funksionin e tij bazuar në një kontratë punësimi me afat të një funksionari publik, e cila gjen rregullim të posaçëm në dispozitat e ligjit organik të Gjykatës së Lartë (nenet 20-21) [...]. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se gjykatat duhet të kishin konkluduar se me mbarimin e mandatit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, do të konsiderohet ipso jure se ka mbaruar dhe kontrata e punësimit të ndihmësit të tij ligjor. Në këto raste, urdhri i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të ndihmësit ligjor, për shkak të mbarimit të kontratës së punësimit, në vetvete vetëm konstaton mbarimin e kontratës së punës që ndihmësi ligjor ka me institucionin. [...]*”.

3.2.3. Në vijim të këtij arsyetimi, si gjyqtare në pakicë, konstatoj se urdhri nr. {***}, datë 31.07.2017, “Për lirim nga detyra”, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ka sjellë pasoja ligjore konkrete për z. Alfred Balla. Lidhur me këtë fakt, e gjej të pabazuar analizën që shumica e trupit gjykues i bën këtij urdhri, në drejtim të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të tij, në kushtet kur një analizë e tillë tejkalon juridiksionin dhe kompetencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të përcaktuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të procesit të rivlerësimit.

3.2.4. Sa më sipër, është e qartë se përfundimi i marrëdhënies së punës të z. Balla me Gjykatën e Lartë ka ardhur *për arsye ligjore*, të pavarura prej tij. Nuk ekziston lidhje shkak-pasojë mes vullnetit apo veprimeve të tij dhe përfundimit të marrëdhënies së punës, për shkak të së cilës, *ex officio*, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit.

3.3. *Së treti*, si gjyqtare në pakicë, nuk jam dakord me arsyetimin që shumica i bën analizës së veprimeve të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, përgjatë harkut kohor nga përfundimi i marrëdhënies në Gjykatën e Lartë dhe deri në procesin gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, të cilat, mbështetur edhe në vendimet e mëparshme të Kolegjit, i vlerëson si përpjekje të subjektit për t’iu shmangur procesit të rivlerësimit, duke sjellë për pasojë zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

3.4. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, konstatoj se rrethanat specifike të kësaj çështjeje, në raport me vendimmarrjet e mëparshme të Kolegjit, e përjashtojnë klasifikimin e saj në kuadër të heqjes dorë, në kuptim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Gjatë kohës kur z. Balla kishte shkëputur marrëdhëniet financiare me Gjykatën e Lartë, më datë 30.11.2017, ka aplikuar për pozicionin kushtetues të anëtarit të KLP-së, si pjesë e shoqërisë civile, pasi ligji nuk kishte të

përcaktuar se ndihmësit ligjor kanë të drejtë të kalojnë në një detyrë tjetër të barasvlershme apo të vazhdonin detyrën aty edhe pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Në këtë pozicion është zgjedhur nga Kuvendi, në datën 08.02.2018, duke iu nënshtruar një procesi vlerësimi paraprak të kushteve dhe kriterëve ligjore, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Aplikimi/përzgjedhja e z. Balla si anëtar i KLP-së, nga *shoqëria civile*, nuk kushtëzohet me kalimin e procedurave të rivlerësimit.

3.5. Në këto kushte, nuk e gjej të drejtë arsyetimin e përdorur nga shumica në paragrafin 11.8 të vendimit dhe vlerësoj zgjedhjen e z. Balla për të qenë pjesë e KLP-së, si një e drejtë kushtetuese dhe ambicie profesionale dhe personale e tij, e cila nuk bie ndesh apo është në papajtueshmëri me të drejtat që buronin nga statusi i këshilltarit ligjor, të cilin nuk e gëzonte në momentin e aplikimit në këtë pozicion, të pakushtëzuar nga vullneti i tij.

Ngjarjet procedurale të iniciuara nga z. Balla, të tilla si: (i) kërkesa drejtuar Komisionit; (ii) shqyrtimi gjyqësor i përfundimit të marrëdhënieve të punës; si dhe (iii) kërkesat pranë KLGj-së, për qartësimin e gëzimit ose jo të statusit të ndihmësit ligjor, çmoj se duhen vlerësuar si domosdoshmëri në drejtim të përcaktimit të ecurisë profesionale të tij.

4. Në përfundim, vlerësoj se rrethanat faktike dhe ligjore të çështjes objekt shqyrtimi nuk janë të tilla që të bëjnë të zbatueshëm nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe ndalimin e parashikuar në të, kështu që, vendimin e shumicës, të dhënë për z. Balla pas pesë viteve në të cilat ai ka ushtruar detyrën e anëtarit/Kryetarit të KLP-së, e vlerësoj të pabazuar në ligj dhe në prova.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi